

Departamenti Amerikan i Punës

Gjetjet mbi Format më të Rënda të Punësimit të Fëmijëve gjatë vitit 2023

Kosovë

Në vitin 2023, Kosova bëri një përparim të moderuar në përpjekjet për të eliminuar format më të rënda të punësimit të fëmijëve. Qeveria miratoi një amendament të Ligjit për Shërbimet Sociale dhe Familjare, i cili vazhdon të kërkojë ofrimin e shërbimeve sociale për popullatat në rrezik dhe tani ndalon punën e fëmijëve në klube nate dhe vende të ngjashme. Ai gjithashtu kërkon trajtim mjekësor dhe psikologjik si dhe kompensim për viktimat e abuzimit të fëmijëve. Qeveria gjithashtu dyfishoi buxhetin për inspektoratin e saj të punës, duke e rritur atë nga pothuajse 875,000 dollarë në 2022 në mbi 1,706,000 dollarë në 2023 dhe punësoi 25 inspektorë pune shtesë. Përveç kësaj, Komuna e Prishtinës udhëhoqi një program të ri pagesash të mirëqenies sociale dhe kujdesit ndaj fëmijëve për familjet nën kufirin kombëtar të varfërisë. Megjithatë, përkundër këtyre përpjekjeve, Komiteti për Parandalimin dhe Eliminimin e Formave të Rënda të Punës së Fëmijëve vazhdoi të mos ketë mbështetjen financiare të nevojshme për të koordinuar veprimet e qeverisë për të luftuar punën e fëmijëve dhe fëmijët nga grupet e pambrojtura hasën pengesa për qasjen në arsim.

Veprimet e sugjeruara më poshtë për qeverinë do të mbyllnin boshllëqet që Departamenti Amerikan i Punës ka identifikuar në zbatimin nga ana e Kosovës të angazhimeve të saj ndërkombëtare për eliminimin e formave më të rënda të punës së fëmijëve.

| Sugjerime për Veprime nga Qeveria për të Eliminuar Punën e Fëmijëve | | |
|---|---|------------|
| Fusha | Sugjerime për Veprim | Citime |
| Kuadri Ligjor | Të penalizohen dhe të jepen dënime për shfrytëzimin nga klienti të një fëmije për prostitucion, pavarësisht nëse fëmija është viktimë e trafikimit. | |
| Zbatimi | Të kryhen inspektimet e punës në sektorin joformal, përfshi edhe tregjet. | (12) |
| Koordinimi | Të garantohet përmirësimi i komunikimit ndërministror midis Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe organeve të tjera qeveritare, për çështje që lidhen me hartimin dhe zbatimin e politikave për punën e fëmijëve. | (12) |
| Programet Sociale | Të grumbullohen dhe publikohen të dhënat mbi shtrirjen dhe natyrën e punës së fëmijëve në Kosovë. | (12) |
| | Të eliminohen pengesat dhe arsimi të bëhet i disponueshëm për të gjithë fëmijët, të bëhen përpjekje shtesë për regjistrimin e fëmijëve me origjinë ashkali, egjiptiane ballkanike dhe rome qysh në lindje, të sigurohen materiale mësimore në gjuhën amtare dhe të subvencionohet transporti. | (12,15,42) |